



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 661 Akti

Nr. 757 Vendimi
Tiranë, më 9.4.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Genta Tafa (Bungo)	Relatore
Roland Ilia	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 9.4.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Erjon Shqarri**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të

paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit Erjon Shqarri, aktualisht me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, është subjekt rivlerësimi, që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) në datën 15.12.2020 zhvilloi procedurën e shpërndarjes me short të çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit Erjon Shqarri do t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Roland Ilia dhe Suela Zhegu. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Genta Tafa (Bungo).
4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 24.12.2020 u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues znj. Suela Zhegu, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.
5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Erjon Shqarri nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.
8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e

veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK); Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP). Këto raporte janë administruar nga relatorja me fillimin e hetimit administrativ.

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Erjon Shqarri. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

11. AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka dërguar raportin² e saj për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Erjon Shqarri.

12. KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 19.3.2024 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 30.4.2018.

² Raporti nr. *** prot., datë 31.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH nr. *** , datë 12.5.2022.

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 28.2.2023.

15. Subjekti i rivlerësimit në datën 20.3.2024 u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 21.3.2024, ndërsa më 2.4.2024 ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në përgjigje të rezultateve të hetimit.

16. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore⁴.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *email*, në datën 5.4.2024.

18. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 9.4.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.

19. Subjekti i rivlerësimit Erjon Shqarri mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Z. Erjon Shqarri ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë të gjithë procedurës së hetimit administrativ.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21.1 Referuar vendimit nr. 2/2017⁵ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë

⁴ Vendimi i ndërmjetëm nr. 3, datë 4.4.2024.

⁵ “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore, që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend

kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga AKSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) gjetjet dhe opinionin e paraqitur me shkrim nga vëzhguesi ndërkombëtar; (g) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike.

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe në burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

23.1 Subjekti ka filluar detyrën në dhjetor të vitit 2015, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

23.2 Në deklaratën *Vetting* (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 28.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

24. Apartament banimi⁶, i ndodhur në pallatin nr. ***, Lagjja Nr. *, rruga “M.U”, nr. *, kati *, me sipërfaqe 113 m².

24.1 Subjekti i rivlerësimit është shprehur: *“Bazuar në deklaratën noteriale nr. ***, datë 8.10.2016, përpara noteres F.A, nga ana ime, në këmbim të heqjes dorë nga apartamenti i përfutur sipas kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 26.8.2011, është pranuar të përfitohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet që vijnë për një apartament tjetër, që ndodhet në të njëjtin objekt, në të njëjtën hyrje, në katin e katërt të banimit, dhe se përveç këmbimit të apartamentit sa më sipër, kushtet e tjera nuk do të pësojnë ndryshime dhe se referimet do t'i bëhen kontratës së cituar më lart”.*

24.2 Në nenin 4 të kontratës së sipërcituar është parashikuar se janë shlyer dy këste në shumën prej 55.000 mijë euro dhe se kësti i tretë dhe i fundit, i barabartë me shumën 12,900 euro, do

edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 26.8.2011; (ii) deklaratë noteriale nr. ***, datë 8.10.2016. (iii) kontratë sipërmarrjeje ndërtimi nr. ***, datë 17.3.2010.

të paguhet në momentin e nënshkrimit dhe referimet do t'i bëhen kontratës së sipërcituar. Vlera: 67,900 euro. Pjesa takuese: 50 %.

Burimi sipas deklaratës Vetting: “Burimi për blerjen e këtij apartamenti është kredia në BKT me vlerë 5,650,000 lekë dhe kursimet familjare nga pagat e mia dhe të bashkëshortes në vite nga puna si prokuror (2,500,000 lekë)”.

Hetimi⁷/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

25. Në datën 26.8.2011 është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. *** midis shoqërisë sipërmarrëse “V-N” sh.p.k. dhe porositësit Erjon Shqarri për ndërtimin e apartamentit nr. *, kati *, i përbërë 2+1 dhe ambiente ndihmëse, me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi 97 m², ndodhur në Durrës.

25.1 Në nenin 4 të kontratës është përcaktuar çmimi në shumën 67,900 euro (konvertuar⁸ në lekë në 9,390,570 lekë), i cili do të likuidohet me këste si vijon:

- a) kësti i parë në shumën 15,000 euro është likuiduar me nënshkrimin e kontratës jashtë zyrës noteriale;
- b) kësti i dytë në shumën 40,000 euro brenda datës 25.10.2011;
- c) kësti i fundit në shumën 12,900 euro do të likuidohet në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes.

25.2 Subjekti në deklaratën Vetting ka deklaruar se i detyrohet shoqërisë “V-N” sh.p.k. shumën 12,900 euro për blerjen e apartamentit.

26. Komisioni ka administruar për ekonomi gjyqësore dosjen e hetimit të kryer për bashkëshorten e subjektit, znj. A.J.

26.1 Lidhur me pagesën e vlerës së apartamentit, bashkëshortja e subjektit sqaron si vijon⁹:

- Kësti i parë 15,000 euro është shlyer sipas parashikimit në kontratën e datës 26.8.2011, *cash*, jashtë zyrës së noterisë, por nuk disponon faturë, me burim kursimet nga paga në vite, të deklaruara përkatësisht në deklaratat periodike vjetore të pasurisë (2004 – 2009).
- Kësti i dytë 40,000 euro është kryer nëpërmjet bankës, në datën 16.11.2011, datë në të cilën është kryer disbursimi i kredisë së marrë nga bashkëshorti në BKT, dega Peqin, sipas kontratës së kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.11.2011. Bashkëshortja e subjektit ka bashkëlidhur edhe kopje të vërtetimit bankar nga BKT-ja, datë 18.4.2019, për të provuar kalimin e këstit për blerje apartamenti në shumën 5,625,250 lekë, në datën 16.11.2011.
- Kësti i tretë nuk është likuiduar ende, pasi sipas parashikimeve në kontratë do të likuidohet në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, e cila kryhet në momentin e regjistrimit të pasurisë.

27. Në datën 8.10.2016 është nënshkruar deklarata noteriale nr. *** nga shoqëria sipërmarrëse “V-N” sh.p.k., subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi A.Sh, sipas së cilës është rënë dakord që

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 22.2.2021, i ASHK-së Durrës; shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar FSHU-së; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 9.2.2021, FSHU-së; shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar UKD-së, UKT-së, UKE-së; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 8.2.2021, UKD-së; shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar bankave të nivelit të dytë; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 19.2.2021, e BKT-së.

⁸ Kursi mesatar i vitit 2011 është 138,3 lekë.

⁹ Për më tepër shihni përgjigjet e pyetësorit të datës 23.4.2019.

subjekti të heqë dorë nga apartamenti i porositur (me sip. 97 m², në vlerën 67,900 euro) dhe të përfitojë apartamentin nr. *, me sip. 113 m², në katin e katërt të banimit, pa ndryshuar çmimi dhe as kushtet e tjera sipas kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 26.8.2011.

27.1 Në këtë deklaratë noteriale, shtetasi A.Sh ka dhënë pëlqimin e tij, pasi ka pasur një marrëdhënie kontraktore për këtë apartament, që është porositur prej tij me kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 17.3.2010, kundrejt çmimit 71,190 euro.

27.2 Shtetasi A.Sh ka hequr dorë nga të gjitha të drejtat e pronësisë për apartamentin, i cili i ka kaluar subjektit, duke deklaruar se nuk ka asnjë pretendim për këtë pasuri, si nga shoqëria “V-N” sh.p.k., ashtu edhe nga subjekti.

28. Në lidhje me apartamentin e shtetasit A.Sh, ka rezultuar se në datën 17.3.2010 ai ka lidhur kontratën e sipërmarrjes nr. *** me shoqërinë “V-N” sh.p.k., duke porositur apartamentin nr. *, me sipërfaqe të përgjithshme 113 m², në katin e katërt të banimit.

28.1 Në nenin 4 të kontratës është përcaktuar çmimi në shumën 71,190 euro, i cili do të likuidohet me këste si vijon:

- a) kësti i parë në shumën 15,000 euro është likuiduar me nënshkrimin e kontratës jashtë zyrës noteriale;
- b) kësti i dytë në shumën 35,000 euro brenda datës 20.4.2010;
- c) kësti i tretë në shumën 15,000 euro brenda datës 20.10.2010;
- d) kësti i fundit në shumën 6,190 euro do të likuidohet në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes.

28.2 Për sa më sipër, rezulton se shtetasi A.Sh ka paguar në total për këtë apartament shumën 65,000 euro, ndërkohë që subjekti për apartamentin e tij ka paguar shumën 55,000 euro.

29. Bashkëshortja e subjektit gjatë hetimit administrativ të saj ka sqaruar se¹⁰ shtetasi A.Sh është vëllai i subjektit dhe se arsyeja e këmbimit ka qenë fakti se ai ka hequr dorë nga blerja e apartamentit. Lidhur me diferencën në çmim, bashkëshortja e subjektit ka shpjeguar se ajo dhe subjekti kanë kryer disa punime të brendshme në këtë apartament rreth asaj vlere, të cilat do të përlllogariten saktësisht në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes, pas hipotekimit të pallatit.

29.1 Për të provuar këtë pretendim, bashkëshortja e subjektit ka depozituar deklaratën noteriale nr. ***, datë 2.5.2019, të shoqërisë “V-N” sh.p.k., me administrator shtetasin F.V, i cili në cilësinë e administratorit dhe ortakut deklaroi se referuar deklaratës noteriale nr. ***, datë 8.10.2016, në të cilën është parashikuar se në këmbim të heqjes dorë nga apartamenti i mëparshëm shtetasi Erjon.S.Shqarri ka marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet për apartamentin në katin e katërt të banimit, vlera e të cilit është 71,190 euro, duke lënë të pandryshuar diferencën në çmim mes këtyre dy apartamenteve.

29.2 Gjithashtu, ai deklaroi se kjo diferencë nuk është ndryshuar, pasi shtetasi Erjon Shqarri ka kryer disa punime në këtë apartament, siç janë dyert, hidrosanitaret, të cilat kanë vlerë të përafërt me këtë diferencë çmimi, që do të përlllogariten saktësisht në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes pas hipotekimit të pallatit.

¹⁰ Shihni përgjigjet e subjektit në pyetësorin e datës 23.4.2019.

29.3 Bashkëshortja e subjektit ka deklaruar se¹¹ vlera e shpenzimeve të kryera për punimet e brendshme është rreth 450,000 lekë, si dhe se këto punime janë kryer në fund të vitit 2011, me burim kursimet nga pagat.

30. Komisioni ka kërkuar e administruar të gjitha kontratat e sipërmarrjes dhe porosisë, si dhe deklaratat noteriale për apartamentet e këtij pallati, të përcjella nga noterja F.A¹², nga shqyrtimi i të cilave nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit, bashkëshorti i saj Erjon Shqarri, si dhe vëllai i bashkëshortit, z. A.Sh, të kenë lidhur kontrata sipërmarrjeje ose porosie me shoqërinë “V-N” sh.p.k. për pasuri të ndryshme nga ato të përmendura në deklaratën noteriale të datës 8.10.2016.

31. ASHK Durrës informon se subjekti ka paraqitur kërkesë për t’u përfshirë në procesin e legalizimit me nr. aplikimi ***, datë 10.12.2020, lloji i pasurisë apartament kati i *** i banimit, kati i *** i ndërtimit, hyrja nr. *, subjekti ndërtues “V-N” sh.p.k., me adresë Lagjja Nr.*, rruga “M.U”, Bashkia Durrës.

31.1 Bashkëshortja e subjektit gjatë procesit të saj në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit ka vënë në dispozicion vendimin nr. ***, datë 12.11.2021, të ASHK Drejtoria Vendore Durrës “Për legalizimin e ndërtimit pa leje”, sipas të cilit është vendosur legalizimi i ndërtimit pa leje, në zotërim të z. Erjon Shqarri.

32. Nga verifikimi i deklaratave periodike rezulton se:

- a. Në DPV-në e vitit 2011, subjekti në deklaratën periodike të bashkëshortes së tij deklaroi kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.8.2011, me porositës z. Erjon Shqarri dhe palë investitore shoqërinë “V-N” sh.p.k. Paga dy këste në shumën 55,000 euro. Si burim janë deklaruar pagat dhe kredia e marrë në BKT.
- b. Në deklaratën përpara fillimit të detyrës, plotësuar në datën 27.11.2015, rezulton se subjekti ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes nr. ***, lidhur në datën 26.8.2011, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 97 m².
- c. Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2016, subjekti deklaroi apartament banimi në pallatin nr. ***/B, Lagjja Nr. *, rruga “M.U”, nr. *, kati i **, me sipërfaqe 113 m², përfituar sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.10.2016. Vlera 67,900 euro.

33. Në pyetësorin standard subjekti deklaroi se nga dhjetori i vitit 2011 kanë përdorur apartamentin e ndodhur në Lagjen Nr. *, rruga “M.U, pallati **/B, kati i **, hyrja nr. ** (apartament në të cilin banon aktualisht), i cili deri përpara përpilimit të deklaratës noteriale nr. ***rep., nr. *** kol., datë 8.10.2016, ka qenë porositur nga vëllai i tij A.Sh. Arsyeja e përdorimit të këtij apartamenti ka qenë se në momentin kur ka ardhur për të banuar në këtë apartament, pallati ishte në ndërtim e sipër, ndërsa kjo hyrje ishte pothuajse e përfunduar. Pasi janë akomoduar në këtë banesë, vëllai A.Sh ka hequr dorë nga blerja e apartamentit dhe kanë rënë dakord me ndërtuesin që të përfitojnë këtë apartament, pasi jetonin aktualisht, duke hequr dorë nga apartamenti i porositur nga ana e tyre. Për këtë fakt, kanë përpiluar deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.10.2016, mbi bazën e së cilës, në këmbim të heqjes dorë nga apartamenti i mëparshëm, në të cilin nuk kanë jetuar asnjë ditë, kanë marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet për apartamentin ku jetojnë aktualisht.

¹¹ Përgjigje pyetësorit datë 9.6.2019.

¹² Për më tepër shihni shkresën e protokolluar pranë Komisionit me nr. ***, datë 4.7.2019.

34. Në lidhje me mobilimin, subjekti në pyetësin standard deklaron se: “*Vlera e arredimit të apartamentit e kryer gjatë viteve është rreth 700,000 lekë. Në vitin 2012 janë shpenzuar rreth 200,000 lekë, në vitin 2013 rreth 250,000 lekë, në vitin 2016 rreth 250,000 lekë. Një pjesë e mobilieve dhe orendive shtëpiake janë blerë nga ana ime përpara celebrimit të martesës, gjatë viteve 2007 – 2009, si dhoma e gjumit, kolltukët, tavolina dhe elektroshtëpiaket, televizori dhe lavatriçja. Nuk disponojmë fatura blerjeje për arsye të kohës së gjatë që ka kaluar nga blerja e tyre. Mobiliet janë bërë nga shtetasi M.K, Tiranë”.*

Analiza financiare për pasurinë apartament

35. Ky apartament është paraqitur në vlerën e tij të plotë 67,900 euro (ose 9,390,570 lekë¹³), në seksionin e pasurive të vitit 2011.

36. Lidhur me kursimet nga paga në vitet 2004 – 2009, si burim financiar për të paguar këstin e parë, në shumën 15,000 euro

36.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se kësti i parë për blerjen e apartamentit është paguar me kursimet ndër vite në shumën 2,500,000 lekë. Në lidhje me këtë deklaram rezultan se:

i. Nga verifikimi i deklaratave periodike të bashkëshortes së subjektit:

- në DPV-në e vitit 2004 deklaron kursime *cash* në shumën 300,000 lekë;
- në DPV-në e vitit 2005 deklaron gjendje *cash* në shumën 500,000 lekë;
- në DPV-në e vitit 2006 deklaron gjendje *cash* në shumën 700,000 lekë;
- në DPV-në e vitit 2007 deklaron kursime *cash* nga paga, mbajtur në shtëpi, në shumën 520,000 lekë;
- në DPV-në e vitit 2008 deklaron kursime *cash* nga paga, mbajtur në shtëpi, në shumën 450,000 lekë;
- në DPV-në e vitit 2009 deklaron kursime *cash* nga paga, mbajtur në shtëpi, në shumën 160,000 lekë;
- në DPV-në e vitit 2012 deklaron kursime *cash* nga paga, mbajtur në shtëpi, në shumën 200,000 lekë.

ii. Në përgjigjet e pyetësorit të datës 17.7.2019, bashkëshortja e subjektit deklaron se gjendja *cash* në fund të vitit 2010 ka qenë 2,200,000 lekë. Në deklaratën e pasurisë *Vetting* është deklaruar e gjithë vlera totale e kursimeve e përdorur për apartamentin, konkretisht pagesa e këstit të parë 15,000 euro, konvertuar në rreth 2,050,000 lekë, plus vlerën e rregullimeve prej 450,000 lekësh, të shpenzuara në vitin 2011, në total 2,500,000 lekë.

36.2 Në përgjigjet e pyetësorit të datës 17.7.2019, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar në lidhje me trajtimin mjekësor në Angli në vitin 2010 se, meqenëse trajtimi mjekësor është kryer në muajt shkurt – mars 2010, për të përballuar kostot është përdorur një pjesë e kursimeve *cash* ndër vite, diferenca 430,000 lekë (2,630,000 – 2,200,000). Si rezultat i të ardhurave të marra gjatë vitit 2010 është zëvendësuar deri në fund të vitit pjesa e kursimeve të shpenzuara.

36.3 Komisioni ka kryer një analizë financiare për mundësinë financiare të subjektit dhe personave të lidhur me të për krijimin e gjendjes *cash* ndër vite¹⁴. Nga analiza financiare

¹³ Përlllogaritur me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2011.

¹⁴ Për më shumë referojuni tabelës nr. 1 të rezultateve të hetimit.

rezulton se subjekti dhe bashkëshortja kanë pasur mundësi për krijimin e gjendjes *cash* ndër vite.

37. Lidhur me kredinë si burim financiar për blerjen e apartamentit

37.1 Subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar si vijon:

- *Kredi bankare për blerje shtëpie, marrë në Bankën Kombëtare Tregtare, dega Peqin, në muajin nëntor 2011, për një periudhë 20-vjeçare, me interes 9.5%, për një shumë prej 5,650,000 lekësh.*
- *Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.11.2011, e lidhur me BKT-në, dega Peqin, nga Erjon Shqarri.*
- *Kontratë hipotekimi nr. ***, datë 10.11.2011, para noterës E.D, noteria Durrës, me studio në Peqin, me hipotekues S.Sh dhe përfitues BKT, dega Peqin.*
- *Shuma e detyrimit financiar e pashlyer deri më 19.1.2017 është 4,798,860 lekë.*

38. Nga dokumentacioni i administruar nga BKT-ja¹⁵ rezulton se:

- a. Në datën 10.11.2011 është lidhur kontrata e kredisë bankare nr. *** midis BKT-së dhe subjektit të rivlerësimit për akordimin e një kredie në shumën 5,650,000 lekë, me afat 240 muaj.
- b. Në cilësinë e dorëzanësit është bashkëshortja e subjektit.
- c. Si garanci për shlyerjen e kredisë me kontratë hipotekimi nr. ***, datë 10.11.2011, është vendosur në hipotekë pasuria:
 - *truall dhe ndërtesë me sipërfaqe 131 m² dhe sipërfaqe kati 96 m², nr. pasurie ***, z. k. ***;*
 - *shtesë objekti dhe ngritje kati banese me sipërfaqe totale 136 m², 1 kat përdhe me sipërfaqe 72 m², kati i parë me sipërfaqe 136 m² dhe kati i dytë papafingo me sipërfaqe 84 m², nr. pasurie ***, z. k. ***. Të dyja këto pasuri janë të regjistruara në emër të shtetasit S.Sh.*
- d. Në aneksin e kontratës së kredisë përcaktohet se kreditimi do të përdoret për blerje shtëpie. Në aneksin e elementeve specifike të kredisë përcaktohet se shuma e kredisë prej 5,650,000 lekësh do të përdoret për likuidimin e blerjes së apartamentit dhe shuma e disbursuar do të transferohet nga llogaria e kredisë në llogarinë e shitësit të objektit të kredituar “V-N” sh.p.k., me transfertë bankare nëpërmjet BKT-së.

39. Nga nxjerrja e llogarisë bankare të subjektit në lekë nr. *** pranë BKT-së rezulton se:

- Në datën 15.11.2011, në këtë llogari është disbursuar shuma 5,565,250 lekë.
- Në datën 16.11.2011, subjekti bën transferimin e shumës 5,565,250 lekë në llogari të shoqërisë “V-N” sh.p.k., me përshkrimin “Pagesë çmimi për blerje apartamenti” (e cila rezulton të jetë për afërsisht e barabartë me shumën 40,000 euro, të parashikuar në kontratën e sipërmarrjes).

¹⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 17.2.2021.

39.1 Për sa më sipër, rezulton se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për kryerjen e pagesave për këtë pasuri.

40. Në përfundim të hetimit, Komisioni konkludon se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit. Subjekti ka kryer deklarim të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

41. Automjet tip “Ford Fiesta TDCI”¹⁶, blerë sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë së luajtshme nr. ***, datë 3.9.2016. Vlera: 150,000 lekë. Pjesa takuese: 50 %.

Burimi sipas deklaratës Vetting: Blerë nga kursimet familjare nga pagat.

Hetimi¹⁷/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

42. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor konfirmon se ky automjet është regjistruar në emër të bashkëshortes, duke përcjellë dosjen e mjetit.

42.1 Nga informacioni i administruar, rezulton se në datën 3.9.2016 është lidhur kontrata e shitblerjes nr. *** midis shtetasit A.Sh, në cilësinë e shitësit, dhe shtetases A.J, në cilësinë e blerësit, për blerjen e automjetit tip “Ford Fiesta”, me targë AA *** FY, me çmimin 150,000 lekë.

43. Bashkëshortja e subjektit gjatë procesit të saj të rivlerësimit ka sqaruar¹⁸ se për caktimin e vlerës së automjetit është bazuar në Udhëzimin nr. 24, datë 11.9.2015, të Ministrit të Financave “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 25, datë 30.11.2007, “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhëna të disponueshme, si dhe zhdoganimin e mjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre”, sipas të cilit parashikohet: “Për autovetura deri në 1400 cc, vlera nuk mund të përlllogaritet më pak se 130,000 lekë (automjeti i blerë sipas subjektit ka fuqi motorike 1400 cc)”, udhëzim të cilin e ka bashkëlidhur në përgjigjen e saj.

44. Nga verifikimi i të dhënave në sistemin e AMF-së rezulton se ky automjet nuk është përdorur nga subjekti dhe bashkëshortja e tij përpara datës së blerjes, 3.9.2016. Gjithashtu, nga verifikimi i të dhënave në sistemin TIMS, rezulton se ky automjet është përdorur prej tyre në vitin 2018. Automjeti rezulton të jetë shitur me kontratën nr. ***, datë 24.12.2019, për shumën 100,000 lekë.

45. Në deklaratën Vetting dhe DVP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar se si burim për blerjen e automjetit kanë shërbyer kursimet familjare nga pagat. Bashkëshortja e subjektit, pasi është pyetur në lidhje me datën e saktë kur është kryer pagesa e shumës prej 150,000 lekësh, deklaroi¹⁹ se kjo pagesë është kryer *cash*, për shkak të lidhjes së afërt familjare me shitësin, në datën 3.9.2016.

46. Komisioni ka kryer një analizë financiare²⁰ për mundësinë e subjektit dhe personave të lidhur me të për blerjen e automjetit tip “Ford Fiesta”, në vlerën totale 150,000 lekë. Nga

¹⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kontratë shitjeje nr. ***, datë 3.9.2016. (ii) shkresë nr. *** prot., datë 24.1.2017, e Drejtorisë Rajonale Durrës; (iii) certifikatë pronësie.

¹⁷ Shkresë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor nr. *** prot., datë 28.1.2021; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 9.2.2021, e DPSHTRR-së.

¹⁸ Pyetësori datë 23.4.2019, pika 2.

¹⁹ Pyetësori datë 17.6.2019, përgjigjja nr. 7.

²⁰ Për më shumë referojuni tabelës nr. 2 të rezultateve të hetimit.

analiza financiare rezulton se subjekti dhe personat e tjerë të lidhur me të kanë pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie.

47. Në përfundim të hetimit konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit. Subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

48. Gjendje në llogarinë rrjedhëse²¹ të pagës së subjektit në Raiffeisen Bank, në datën 23.1.2017 (nuk ka pasur ndryshime pas kësaj date). Vlera: 9,349 lekë.

Hetimi²²/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

49. Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në Raiffeisen Bank rezulton se gjendja e saj në datën 23.1.2017 është 6,129.03 lekë.

50. Në përfundim të hetimit, Komisioni nuk krijon dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit. Subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

51. Subjekti nuk ka deklaruar pasuritë e bashkëshortes së tij, por i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* deklaratën e bashkëshortes, ku kjo llogari bankare rezulton e deklaruar.

52. Bashkëshortja e subjektit në deklaratën *Vetting*, përveç pasurive të trajtuara më lart, ka deklaruar tokë bujqësore, e ndodhur në fshatin H, Bulqizë, me sip. 1000 m², nga e cila 700 m² arë dhe 300 m² truall. Pjesa takuese: $\frac{1}{3}$ e 1000 m² ose 33.3%.

52.1 Mënyra e fitimit të pronësisë: fituar me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi nr. ***, datë 2.3.1999, si anëtare e familjes bujqësore në vitin 1991, sipas certifikatës së trungut familjar nr. ***, lëshuar në datën 14.10.2016, me kryefamiljare znj. V.J (gjyshja) dhe anëtarë A.J dhe H. J. Kjo pasuri është deklaruar edhe në DPV-në e vitit 2003 nga bashkëshortja e subjektit.

53. ASHK Bulqizë, me shkresën nr. *** prot., datë 4.7.2019, informon se shtetasja V.J ka regjistruar AMTP-në nr. ***, sipas së cilës në cilësinë e përfaqësueses së familjes bujqësore ka përfituar pasurinë nr. *** me sipërfaqe 700 m² arë.

Bashkëlidhur shkresës gjendet AMPT-ja nr. ***, datë 2.3.1999, sipas së cilës shtetasja V.J në cilësinë e kryefamiljarit ka përfituar 1000 m² tokë, nga e cila 700 m² tokë bujqësore arë dhe 300 m² truall.

54. Në përfundim të hetimit konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri.

GJETJE TË TJERA

55. Subjekti në DPV-në e vitit 2009 të bashkëshortes së tij ka deklaruar:

- *kredi bankare në BKT, në shumën 15,000 euro, me afat 5-vjeçar, marrë në datën 18.5.2004;*
- *detyrimi 0 në datën 17.5.2009;*
- *kredi bankare në BKT, në shumën 10,000 euro, me afat 7-vjeçar, detyrimi 3,900 euro.*

²¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank.

²² Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 15.2.2021, e Raiffeisen Bank.

55.1 Nga dokumentacioni i administruar nga BKT-ja²³ në lidhje me këto dy kredi, rezulton se:

- a) Në datën 30.4.2004, me kontratën e kredisë nr. ***, subjekti ka marrë nga BKT-ja hua në shumën 15,000 euro për rregullim shtëpie, me afat 60 muaj. Dorëzanës në këtë kredi rezultojë prindërit e subjektit dhe si garanci²⁴ është vënë shtëpia e banimit dykatëshe e prindërve të tij.

Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në BKT rezulton se:

- në datën 18.5.2004 është disbursuar huaja në shumën 14,700 euro;
- në datën 20.5.2004, subjekti ka tërhequr shumën 14,450 euro.

- b) Në datën 18.4.2005, me kontratën e kredisë nr. ***, subjekti ka marrë nga BKT-ja hua në shumën 10,000 euro për rregullim shtëpie, me afat 84 muaj. Dorëzanës në këtë kredi rezultojnë prindërit e subjektit, si dhe bashkëshortja A.J dhe si garanci²⁵ është vënë shtëpia e banimit dykatëshe e prindërve të tij.

Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në BKT rezulton se:

- në datën 27.4.2005 është disbursuar huaja në shumën 9,800 euro;
- në datën 5.5.2005, subjekti ka tërhequr shumën 9,600 euro.

56. Në DPV-në e vitit 2010, bashkëshortja e subjektit deklaroi llogari rrjedhëse në BKT, hapur në datën 12.1.2010 dhe mbyllur në datën 29.1.2010, me qëllim aplikim për vizë. Në po të njëjtën deklaratë subjekti kryen të njëjtin deklaram si bashkëshortja e tij për një llogari bankare në shumën 500,000 lekë.

- a) Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortes së subjektit në BKT në lekë konstatohet se:

- në datën 12.1.2010 është transferuar shuma 400,000 lekë nga llogaria e nënës së tij, znj. N.Sh;
- kjo shumë është tërhequr nga bashkëshortja e subjektit në datën 29.1.2010;

- b) Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në BKT në lekë konstatohet se:

- në datën 12.1.2010 është transferuar shuma 500,000 lekë nga llogaria e nënës së tij, znj. N.Sh;
- kjo shumë është tërhequr nga subjekti me dy këste, në datën 25.1.2010, në shumën 84,000 lekë dhe në datën 29.1.2010, në shumën 416,000 lekë.

- c) Në lidhje me transferimin e dy shumave të mësipërme, si dhe të kredive të marra nga subjekti, bashkëshortja gjatë procesit të saj të rivlerësimit²⁶ ka depozituar deklaratën noteriale nr. ***, datë 16.7.2019, sipas së cilës shtetasja N.Sh deklaroi se *nga llogaria e saj bankare kanë kaluar në llogarinë e subjektit dhe bashkëshortes së tij, në vitin 2010, shumat 400,000 lekë dhe 500,000 lekë, me qëllim aplikimin për vizë angleze. Pas marrjes së vizave është bërë tërheqja e këtyre shumave dhe i janë kthyer përsëri... Kreditë e marra nga subjekti kanë qenë kredi familjare dhe janë përdorur për rikonstruksionin e banesës ekzistuese. Për pagimin e këtyre kredive ka kontribuar subjekti dhe pjesën tjetër e kanë paguar ata si familje nga pagat mujore të secilit pjesëtar... Me mbylljen e njërit prej kredive në muajin maj të vitit 2009, kësti 170 euro i kredisë deri në mbylljen e saj në maj të vitit*

²³ Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 17.2.2021.

²⁴ Kontratë hipotekimi nr. ***, datë 30.4.2004.

²⁵ Kontratë hipotekimi nr. ***, datë 18.4.2005.

²⁶ Email i datës 17.7.2019.

2012 është paguar vetëm nga familja e tyre, pasi subjekti është shpërngulur me banim në Durrës...

56.1 Nga hetimi i Komisionit nuk lindën dyshime apo paqartësi në lidhje me këto kredi, si dhe transferimin e shumave të mësipërme, për të cilat rezultoi se nëna e subjektit ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme.

57. Në DPV-në e vitit 2014 të bashkëshortes së tij, subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Audi”, vit prodhimi 2006, me targë origjine ***, blerë në datën 3.5.2014, në vlerën 250,000 lekë dhe zhdoganim në vlerën 141,250 lekë, me burim kursime nga pagat, të cilin ka deklaruar se e ka shitur²⁷ në datën 8.5.2014, në vlerën 300,000 lekë.

57.1 Nga dokumentacioni i përcjellë nga DPSHTRR-ja²⁸ nuk rezultojnë informacione në lidhje me këtë automjet.

i) Gjatë procesit të saj të rivlerësimit, bashkëshortja e subjektit, pasi i është kërkuar informacion dhe dokumentacion në lidhje me transaksionet e kryera për shitjen dhe blerjen e këtij automjeti, si dhe saktësimin e burimit për blerjen e tij, deklaroi²⁹ se bashkëshorti e ka blerë automjetin nga shtetasja Sh.K. Për të provuar këtë deklaram, ajo ka depozituar deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.6.2019, ku znj. K deklaroi se *është mbajtëse e pasaportës britanike nr. *** dhe në vitin 2012 ka udhëtuar nga Anglia në drejtim të Shqipërisë me automjetin tip “Audi”, me targë ***. Gjatë qëndrimit në Shqipëri, ky automjet ka pësuar defekt dhe, për këtë arsye, ka rënë dakord me mikun e familjes Erjon Shqarri që, nëse e rregullonte këtë automjet, do t’ia shiste këtij të fundit. Pas kthimit në Angli, ajo ka kryer procedurat e kalimit të posedimit të automjetit tek Erjon Shqarri, duke deklaruar eksportimin e tij, me qëllim përjashtimin nga taksat në shtetin anglez. Në prill të vitit 2014, ajo ka sjellë në Shqipëri dokumentacionin e automjetit dhe nuk ka bërë aktin e shitjes së tij, pasi dokumenti i lëshuar nga shteti anglez është i mjaftueshëm për kalimin e pronësisë. Çmimi i automjetit në shumën 250,000 lekë i është paguar cash nga blerësi në datën 12.4.2014.*

ii) Bashkëshortja e subjektit deklaroi³⁰ gjithashtu se automjeti është riparuar nga vëllai i subjektit, z. A.Sh (shpenzimi i kryer është 175,000 lekë) dhe, për këtë arsye, menjëherë pas zhdoganimit subjekti ia ka shitur automjetin vëllait me të njëjtën vlerë me të cilën është blerë, plus shumën e paguar për zhdoganimin.

iii) Bashkëshortja e subjektit me *email*-in datë 17.7.2019 ka depozituar deklaratën noteriale nr. ***, datë 16.7.2019, të shtetasit A.Sh, i cili deklaroi se *automjetin tip “Audi” e ka blerë nga vëllai i tij Erjon Shqarri në vitin 2014, siç ishte në gjendje të prishur. Riparimi i automjetit është bërë nga ana e tij, pasi është paguar dogana kur e ka blerë. Riparimi ka kushtuar 175,000 lekë, të cilat i ka paguar ai.*

iv) Ajo ka paraqitur³¹ si provë të kalimit të pronësisë të këtij automjeti tek bashkëshorti i saj dokumentacionin vijues:

²⁷ Sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.5.2014.

²⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 19.4.2019, nga DPSHTRR-ja.

²⁹ Pyetësori datë 17.6.2019, përgjigjja nr. 6.

³⁰ Pyetësori datë 12.7.2019, përgjigjja nr. 4.

³¹ *Email* datë 28.6.2019.

- Kopje të deklaratës doganore nr. R***, datë 3.5.2014, nga e cila rezulton se eksportuesi dhe marrësi i këtij automjeti është shtetasi Erjon Shqarri; vlera e automjetit është 250,000 lekë dhe shuma e paguar për zhdoganimin e tij në këtë datë është 141,250 lekë.
- Kopje të mandatarëkëtimit të bankës CreditAgricole, sipas të cilit subjekti ka paguar në datën 5.5.2014 detyrimet doganore në shumën 141,250 lekë.
- Kopje në gjuhën angleze të certifikatës së regjistrimit³² së automjetit tip “Audi”, me targë ***, në emër të shtetasit Erjon Shqarri, me adresë *** S.H, C.W, Londër³³, të cilën e ka marrë nga mbajtësi i mëparshëm i këtij automjeti, shtetasja Sh.K, në datën 6.2.2012.
- Kopje të kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.5.2014, me anë të së cilës bashkëshorti i saj ia shet këtë automjet vëllait të tij, z. A.Sh, për shumën 300,000 lekë, e cila është paguar jashtë zyrës noteriale.

57.2 Nga të dhënat e AMF-së rezulton se për këtë automjet është prerë policë sigurimi për periudhën 12.11.2013 – 26.12.2013, ku si pronar rezulton subjekti dhe si përdorues vëllai i tij.

57.3 Komisioni përgatiti analizën financiare³⁴ të subjektit dhe bashkëshortit të saj deri në datën 3.5.2014, për të verifikuar aftësinë paguese për blerjen e automjetit.

57.4 Nga analiza financiare duket se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie.

Në lidhje me pasuritë e prindërve të subjektit të rivlerësimit

58. Komisioni ka hetuar edhe për pasuritë e prindërve të subjektit, nga ku ka rezultuar se ZVRPP Peqin³⁵ informon se në emër të shtetasit S.Sh rezultojnë të regjistruara si vijon:

- Pasuria nr. ***, e llojit truall, nga e cila sipërfaqe trualli 238 m² dhe sipërfaqe ndërtese 100.3 m², zona kadastrale ***, Peqin. Në kartelën e pasurisë gjenden tri përshkrime, si vijon:
 - Është marrë leje ndërtimi për shtesë anësore për katin përdhe dhe të parë + papafingo me sipërfaqe ndërtimore 136 m². Diferencë fakt-dok ***.*
Në lidhje me këtë pasuri, babai i subjektit ka bërë deklaratë noteriale nr. ***, datë 10.3.2021, duke qenë dakord me pozicionimin e pasurisë dhe me sipërfaqet e matura sipas planvendosjes së përgatitur.
 - Me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 18.3.2004, babai i subjektit blen shtëpi banimi dykatëshe, me nr. pasurie ***, zona kadastrale ***, lagjja “Ç”, Peqin, me sipërfaqe 96 m², si dhe truall me sipërfaqe 131 m² kundrejt vlerës 500,000 lekë.
 - Në datën 27.11.2006, shtetasi S.Sh ka marrë nga Bashkia Peqin lejen e ndërtimit³⁶ për një shtesë anësore për katin përdhe + katin e parë + ngritje kati (papafingo) të banesës ekzistuese, si dhe në datën 14.2.2007 ka përfutur miratimin e lejes së shfrytëzimit për shtesën e objektit po nga kjo Bashki. Objekti është i regjistruar me nr. pasurie ***, zona kadastrale ***, me sipërfaqe 136 m², lloji shtesë objekti banese dhe ngritje kati të dytë papafingo me sipërfaqe kati përdhe 72 m², kati i parë 136 m² dhe kati i dytë papafingo

³² Lëshuar nga Agjencia Angleze e Licencimit të Automjeteve.

³³ Kjo adresë rezulton si adresë e subjektit dhe bashkëshortes së tij edhe tek fatura e spitalit “****” e datës 10.10.2014 dhe i përket një të afërmi të subjektit.

³⁴ Shihni tabelën nr. 3 të rezultateve të hetimit.

³⁵ Për më tepër shihni shkresën nr. *** prot., datë 24.3.2021.

³⁶ Vendim nr. 5, datë 27.11.2006, i KRRT-së Bashkia Peqin (përgjigjja e ZVRPP-së Peqin).

84 m², ndodhur në lagjen “Ç”, Peqin. Nga akti i kolaudimit të kësaj shtese rezulton se vlera e shtesës është 5,085,852 lekë.

b. Pasuria nr. ***, e llojit truall, me sip. 827 m², në Peqin, ku shtetasi S.Sh është bashkëpronar me 7 shtetas të tjerë. Kjo pasuri është fituar me dëshmi trashëgimie.

59. Nga dokumentacioni i administruar është vënë re se bashkëshorti i subjektit dhe prindërit e tij kanë përfituar kredi në shumën 1,000,000 lekë nga Raiffeisen Bank, sipas kontratës së datës 28.2.2008, me qëllim përdorimi personal.

59.1 Nga nxjerrja e llogarisë së nënës së subjektit në Raiffeisen Bank rezulton se:

- në datën 28.2.2008 është disbursuar kredi në shumën 1,000,000 lekë;
- në po të njëjtën datë tërhiqet shuma 970,000 lekë;
- në datën 28.7.2008 bashkëshortja e subjektit ka transferuar shumën 31,000 lekë.

59.2 Bashkëshortja e subjektit gjatë procesit të saj ka deklaruar³⁷ se bashkëshorti i saj ka pasur vetëm rolin e dorëzanësit në këtë kredi dhe nuk ka qenë kredimarrës. Ajo deklaron gjithashtu se në kontratën e kredisë është shënuar gabimisht emri i bashkëshortit të saj si bashkëkredimarrës dhe se në pjesën e fundit të saj ai ka nënshkruar në cilësinë e dorëzanësit dhe jo të bashkëkredimarrësit.

59.3 Nga dokumentacioni i administruar³⁸ rezulton se në datën 28.2.2008 është lidhur kontrata e kredisë bankare, ku kredimarrës është nëna e subjektit dhe në rolin e bashkëkredimarrësit rezulton subjekti i rivlerësimit dhe babai i tij. Kredia është marrë në shumën 1,000,000 lekë për arsye personale, me afat 59 muaj. Në faqen e fundit të kontratës rezulton se subjekti ka firmosur si dorëzanës, ndërsa si bashkëkredimarrës ka firmosur babai i tij.

60. Në lidhje me këto pasuri të babait të subjektit nuk lindin dyshime apo paqartësi.

61. Komisioni ka kryer analizë financiare³⁹ për periudhën 2003 – 2016, nga ku ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e këtyre pasurive gjatë periudhës 2003 deri në deklaratën *Vetting*.

Konkluzion për vlerësimin e pasurisë

62. Në përfundim, Komisioni, duke u mbështetur edhe në vendimin nr. 2/2022 të Kolegjit, vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën *Vetting* pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

63. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë, si dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit Erjon Shqarri nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

³⁷ Pyetësori datë 17.6.2019, përgjigje nr. 3.

³⁸ Kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 12.4.2019, e Raiffeisen Bank.

³⁹ Shihni tabelën nr. 6.

64. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Erjon Shqarri ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

65. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 31.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 12.5.2022. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Si konkluzion, AKSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Erjon Shqarri.

66. Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur⁴⁰ çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

67. Në Komision kanë mbërritur 5 denoncime lidhur me figurën e subjektit të rivlerësimit. Bazuar në nenin 53/2 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka konsideruar denoncimet për kriterin e kontrollit të figurës të subjektit dhe ka kryer një hetim të mëtejshëm lidhur me këto të dhëna, duke kërkuar informacion në institucionet/organet ligjzbatuese, si dhe nëpërmjet ONM-së në institucionet e huaja.

68. Denoncim nr. * prot., datë 30.4.2019, i ardhur në adresën elektronike të Komisionit nga shtetasi A.Dh.** Ky denoncim paraqet informacione sa i përket subjektit dhe lidhjeve të tij me persona të përfshirë në krimin e organizuar e trafikun ndërkombëtar.

68.1 Komisioni i kërkoi informacion organeve ligjzbatuese lidhur me kontakte të papërshtatshme të z. Erjon Shqarri, duke iu referuar edhe denoncimit përkatës dhe kontakteve të mundshme me persona të papërshtatshëm.

➤ Nga përgjigjet e ardhura nuk u konstatuan *indicie* për hetime të mëtejshme.

69. Denoncim nr. * prot., datë 13.5.2019,** ardhur nga adresa elektronike, identifikuar me emrin E, i cili pretendon se subjekti ka qenë i dënuar në Itali (Padova) për shfrytëzim prostitucioni në vitet 1998 – 2000 dhe se atje mund të ketë përdorur emër tjetër.

69.1 Duke e konsideruar informacionin e denoncuesit me *indicie* që përmbajnë shkaqe të mjaftueshme për fillimin e hetimit kryesisht (neni 53), Komisioni e ka vlerësuar të domosdoshëm verifikimin e tij. Për të realizuar këtë verifikim, Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit të bashkëshortes së subjektit ka kërkuar bashkëpunimin e subjektit me qëllim

⁴⁰ Për një pjesë të hetimit referojuni dosjes me dokumentacion sekret.

verifikimin nëpërmjet gjurmëve të gishtave, dyshimeve të ngritura për probleme me drejtësinë në shtete të tjera dhe me gjeneralitete të ndryshme nga ato aktualisht.

69.2 Komisioni ka kërkuar mbështetjen e organeve ligjzbatuese për verifikimin e informacionit të denoncimit.

69.3 Subjekti ka pranuar të bashkëpunojë me Komisionin për kryerjen e verifikimeve dhe vullnetarisht të ofrojë gjurmët e gishtave që të kryhet ky verifikim.

70. Nga hetimi ka rezultuar se:

i. Konfirmohet se gjurmët e gishtave të marra nga subjekti i përkasin vetëm shtetasit Erjon Shqarri, shtetas shqiptar, i datëlindjes 21.4.1978, duke hedhur poshtë kështu pretendimin e denoncuesit se subjekti mund të ketë përdorur emër tjetër.

ii. Nga të dhënat e autoriteteve policore italiane për subjektin, ka rezultuar se:

- në datën 10.5.1999 është daktiloskopuar nga zyra policore për migracionin në Milano, Itali;
- në datën 9.11.2001 është regjistruar për falsifikim të vulës qeveritare (nenet 465-468-469 të KP italian), përdorim të sendeve të vjedhura, përdorim akti të rremë;
- në datën 6.5.2019 është regjistruar në aeroportin ndërkombëtar Piza, Itali, me nr. pasaporte BJ***.

iii. Nga verifikimet e kryera në shtetin italian Komisioni është informuar se shtetasi Erjon Shqarri, i datëlindjes 21.4.1978, ka një rekord kriminal në datën 25.1.2002, për përdorim të dokumenteve false, falsifikim dhe përdorim të vulës shtetërore, raportuar nga Kuestura Milano, Itali.

71. Komisioni administroi dokumentet që lidhen me këto të dhëna në fashikullin 24 të subjektit të rivlerësimit A.J, në gjuhën italiane, si vijon:

- a. certifikatë e përgjithshme e procedimeve penale të subjektit Erjon Shqarri, e cila rezulton negative;
- b. certifikatë e procedimeve penale, sipas së cilës nuk ka procedime në ngarkim të z. Erjon Shqarri.

72. Në vijim të këtij procesi verifikimi, subjektit i janë kërkuar shpjegime, sipas dijenive të tij, se për çfarë bëhet fjalë në rastet e referuara më lart.

73. Në përgjigje të pyetësorit, subjekti sqaron se lidhur me këtë informacion ka marrë dijeni për herë të parë gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të bashkëshortes A.J, në funksion të të cilit ka vënë në dispozicion të Komisionit, me pëlqimin e tij, gjurmët e gishtave për t'u kryer verifikime lidhur me denoncime anonime për figurën e tij.

74. Për sa i përket informacionit për përdorim të dokumentit të falsifikuar dhe përdorim të vulës shtetërore, ai nuk ka qenë në dijeni të këtyre fakteve, si dhe arsyet përse janë bërë këto raportime, pasi nuk ka përdorur ndonjëherë dokument të falsifikuar. Ai nuk ka qenë në shtetin italian në vitet 2001 dhe 2002 dhe nuk ka përdorur në asnjë rast, as në Itali dhe as në ndonjë vend tjetër, gjeneralitete të tjera, përveç atyre që disponon tani. Ai ka lëvizur lirisht në shtetin italian pas viteve që referojnë këto regjistrime dhe në asnjë rast nuk është njoftuar për ndonjë problem ligjor në këtë shtet. Në datën 25.1.2002 ka qenë në Shqipëri dhe ka qenë duke vazhduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës. Për këtë fakt, ai ka kërkuar dhe ka marrë në rrugë zyrtare, me shkresë përcjellëse nga dekani, regjistrin e vitit

shkollor 2001 – 2002, të kursit 4A, ku rezulton se gjatë këtij viti z. Erjon Shqarri ka ndjekur studimet rregullisht dhe, veçanërisht në datat kur janë bërë këto shënime, ka qenë në mësim. Ky regjistër është dorëzuar pranë Komisionit në procesin e rivlerësimit të bashkëshortes së tij. Në Itali ka qenë për një periudhë të shkurtër kohe, në vitin 1999, pasi ka bërë kërkesë për t'u pajisur me dokumente italiane... ka shkuar në Itali përsëri në vitin 2000, pasi duhej të paraqitej për të marrë përgjigje lidhur me kërkesën për dokumente. Pasi është njoftuar se kërkesa e tij nuk ishte shqyrtuar, është kthyer në Shqipëri dhe nuk ka shkuar në shtetin italian deri në vitin 2012. Në të dyja rastet ai qëndruar tek djali i xhaxhait, z. N.Sh, në Firence.

75. Subjekti gjithashtu ka informuar Komisionin se pas marrjes dijëni, nëpërmjet *email*-it të datës 24.7.2019, për disa të dhëna të regjistruara në emrin e tij, të ardhura nga Interpol Roma, është interesuar privatisht, duke kontaktuar një avokate në Itali, në mënyrë që të informohej lidhur me të dhënat e bëra me dije nga Komisioni, faktin se përse këto të dhëna ekzistojnë në emër të tij, për sa kohë nuk ka qenë në shtetin italian në datën që ata referojnë, si dhe për të kuptuar se për çfarë rrethanash bëhej fjalë konkretisht.

75.1 Nga ana e tij, nëpërmjet avokates, janë siguruar certifikata që nuk është në ndjekje penale në shtetin italian, ku nuk rezulton asgjë e shënuar në emrin e tij, si dhe *visura* (certifikata) pranë Zyrës së Arkivit Qendror, nga e cila rezulton se nuk ka asnjë precedent penal. Certifikata (*visura*) përmban (nëse ka) të gjitha vendimet e dhëna në ngarkim, duke përfshirë edhe ato që janë anuluar për arsye shuarjeje të veprës ose në lidhje me dënime me kusht, dënime që nuk përmenden, siç janë marrëveshjet e fajësisë etj. Avokatja e tij i është drejtuar disa herë me kërkesë Drejtorisë Qendrore të Policisë Kriminale në Ministrinë e Brendshme, ku në përgjigje ka bërë me dije se po marrin të dhëna nga institucionet e varësisë për të verifikuar dhe korrigjuar të dhënat në emrin e tij, të cilat kanë qenë të dhëna të paazhurnuara. Me përgjigjen e datës 15.11.2019, kjo Drejtori ka komunikuar se në këtë datë, në emër të z. Erjon Shqarri, nga Qendra e të Dhënave të Departamentit të Sigurisë Publike rezulton vetëm një arkivim i datës 18.4.2006, që lidhet me rekordin e datës 25.1.2002. Nisur nga kjo e dhënë, nëpërmjet avokates ka kërkuar dokumentacion lidhur me këtë fakt, për të kuptuar se për çfarë është referuar ky arkivim konkretisht, pasi ai nuk ka pasur dijëni. Edhe nga kërkimet e bëra nga avokatja në Kuesturën e Milanos dhe në zyrën e Prokurorisë Milano nuk kanë arritur të gjejnë asnjë dokumentacion apo fashikull lidhur me këtë arkivim. Për këtë arsye, edhe në këto momente ai nuk e di se për çfarë fakti dhe rrethanash është bërë arkivimi dhe lidhur me çfarë dokumentesh është referuar. Gjithsesi, subjekti ka arritur të sigurojë dokumentacionin e plotë, që provon se nuk ka pasur asnjë proces gjyqësor në shtetin italian dhe, aq më tepër, asnjë lloj dënimi për asnjë vepër penale.

76. Subjekti ka bashkëlidhur:

- a. Shkresë datë 26.9.2019, drejtuar Drejtorisë Qendrore të Policisë Kriminale nga av. R. Q.
- b. Përgjigje datë 30.9.2019 e Drejtorisë Qendrore të Policisë Kriminale, sipas së cilës u është kërkuar zyrove përkatëse që të saktësojnë të dhënat në CED.
- c. *Email* datë 30.10.2019, dërguar nga R.Q, e cila ka kërkuar të dhëna nga banka e të dhënave CED.
- d. Përgjigje datë 6.11.2019 e Drejtorisë Qendrore të Policisë Kriminale.
- e. Përgjigje datë 15.11.2019 e Drejtorisë Qendrore të Policisë Kriminale, sipas së cilës rezulton një arkivim në datën 18.4.2006.

- f. *Visura* (certifikatë) nga zyra e Arkivit Qendror të Ministrisë së Drejtësisë, datë 2.10.2019, që i përket Prokurorisë dhe Gjykatës së Milanos, sipas së cilës në bankën e regjistrimit të dosjeve penale nuk rezulton asgjë për subjektin e rivlerësimit.
- g. Përgjigje datë 24.12.2019 e Kuesturës Milano, sipas së cilës nuk ka asnjë dokument, pasi janë asgjësuar.
- h. Shkresë e av. C.P, i cili ka dërguar certifikatat e mëposhtme:
 - certifikatë nga sistemi informatik i dosjeve, datë 19.6.2019, që i përket Prokurorisë dhe Gjykatës së Firences, sipas së cilës në bankën e regjistrimit të dosjeve penale nuk rezulton asgjë për subjektin e rivlerësimit;
 - certifikatë e akuzave në pritje nga Prokuroria Firenze, datë 29.7.2019, sipas së cilës nuk rezulton asnjë procedim në emër të subjektit;
 - certifikatë nga sistemi informatik i dosjeve, datë 2.10.2019, që i përket Prokurorisë dhe Gjykatës së Milanos, sipas së cilës në bankën e regjistrimit të dosjeve penale nuk rezulton asgjë për subjektin e rivlerësimit;
 - certifikatë e ndjekjes penale nga Prokuroria e Milanos, datë 30.7.2019, nga ku rezulton se subjekti nuk është në ndjekje penale.

77. Nga hetimi i Komisionit nuk mund të provohen hyrje-daljet e subjektit jashtë Shqipërisë përpara vitit 2004, pasi Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresën nr. *** prot., datë 16.2.2024, ka informuar se regjistrimi TIMS ka filluar në datën 1.5.2004.

78. Në përfundim të këtij hetimi, Komisioni vlerëson se nuk u provuan *indiciet* e parashtruara në denoncimin nr. *** prot., datë 13.5.2019. Rezulton e provuar se subjekti nuk ka përdorur emër tjetër në Itali. Dokumentacioni i depozituar provon se nuk ka asnjë të dhënë të qartë mbi ndonjë procedim apo dënim të subjektit. Në këtë pikë, Komisioni mban në vëmendje se për periudhën që i referohet denoncuesi, subjekti ka qenë ende student në Fakultetin e Drejtësisë, si dhe rezultoi e provuar nga dokumentacioni i administruar që subjekti ka qenë prezent në leksione dhe seminare.

79. Denoncim nr. * prot., datë 27.9.2023, i shtetasit Z.K.** Ky denoncim flet për një çështje penale konkrete, që nuk i përket subjektit të rivlerësimit, por bashkëshortes së tij. Sipas denoncuesit, subjekti kryen rolin e sekserit në shumë çështje të prokurorëve të Durrësit, pasi bashkëshortja e tij u bën presion për kontroll të dosjeve dhe referim të tyre në ILD.

➤ Në lidhje me këtë denoncim vlerësohet se nuk janë paraqitur të dhëna për hetim të mëtejshëm.

80. Denoncim nr. * prot., datë 26.10.2023, i shtetasit A.S.** Ky shtetas pretendon se subjekti ka lidhje me shtetasin A.R nga Peqini, si dhe është dënuar në Itali me emër tjetër. Po ashtu, ai pretendon se subjekti konsumon alkool dhe është përdorues i lëndëve narkotike, si dhe është sekser i bashkëshortes së tij.

i) Në lidhje me këtë denoncim, Komisioni ka pyetur subjektin për lidhjet e tij me ish-deputetin A.R. Subjekti deklaroi se nuk ka pasur asnjë kontakt për asnjë arsye apo rrethanë. Për këtë shtetas ka dijeni se kush është për shkak të aktivitetit të tij politik si ish-deputet i Kuvendit dhe problematikave lidhur me të, për të cilat ka marrë dijeni nga shtypi i shkruar.

ii) Në lidhje me dënimin në Itali, Komisioni ka hetuar si më sipër, ndërkohë që rezultoi e provuar se ai nuk ka përdorur emër tjetër në Itali, konfirmuar kjo nëpërmjet gjurmëve të gishtëve.

iii) Në lidhje me pretendimin e fundit të denoncuesit, Komisioni vlerëson se nuk ka fakte apo *indicie* për hetim të mëtejshëm.

81. Denoncim nr. * prot., datë 2.10.2023, i shtetasit A.Xh.** Ky shtetas paraqet të njëjtat pretendime sikundër dy denoncuesit e mësipërm, për të cilat Komisioni u shpreh më sipër.

Konkluzion për vlerësimin e kontrollit të figurës

82. Trupi gjykues, pasi kreu një hetim të plotë në lidhje me elementet mbi të cilat bazohet vlerësimi i figurës sipas ligjit nr. 84/2016, vlerësoi të gjitha *indiciet* e ardhura nëpërmjet denoncimeve, provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Erjon Shqarri ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

83. Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLP-ja;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

Raporti i hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë

84. Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

85. Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (ii) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme.

86. Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësia personale dhe angazhimi profesional.

87. Nga verifikimi i tri dokumenteve ligjore të depozituara nga subjekti nuk u konstatuan problematika.

88. Nga analizimi i 5 dosjeve të përzgjedhura me short, subjektit i kaloi barra e provës për dosjen nr. 3, **procedimi penal nr. ***/2016** i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, datë regjistrimi 26.1.2016, regjistruar për veprën penale “Përndjekja”, parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal. Me vendimin datë 23.2.2016 të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për zëvendësimin e prokurorit është ngarkuar subjekti për ndjekjen e hetimeve.

89. Në lidhje me këtë dosje, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit në datën 13.12.2023 ka paraqitur Gjetjen dhe Opinionin, si vijon:

89.1 Për sa i përket dosjes nr. 3 (në lidhje me procedimin penal nr. ***/2016), ngjarjet tregojnë qartë ekzistencën e një rasti përndjekjeje sipas nenit 121/a të Kodit Penal.

89.2 “Shkaktimi i ankthit” është një element subjektiv, që duhet konsideruar duke pasur parasysh ndjenjat e viktimës dhe jo vetëm qëllimin e autorit, por edhe ekzistencën e *dolus eventualis* (që nënkupton pranimin e rrezikut për të shkaktuar atë ngjarje, në të vërtetë ankthin tek një person i caktuar, duke marrë në konsideratë rrethana të caktuara specifike).

89.3 Prokurori përgjegjës i çështjes i nënkualifikoi faktet dhe nuk veprroi siç duhet dhe me kujdes, pasi përgjithësisht veprat me bazë gjinore nuk perceptohen mirë në Shqipëri. Pra, jemi përpara një gabimi të rëndë (nëse jo të qëllimshëm) nga autoriteti prokurorial përkatës, i cili duhet të vlerësohet në kuadër të procesit të *Vetting*-ut.

89.4 Zgjedhja për t’i cilësuar ngjarjet si “fyerje” (sipas nenit 119 të Kodit Penal) dhe jo si “përndjekje” (sipas nenit 121/a të Kodit Penal) minon thelbin e këtyre dispozitave, qëllimin dhe synimet e Konventës së Stambollit dhe Konventës CEDAW dhe i ka shtuar një tjetër problem mungesës së zbatimit të tyre në Shqipëri.

89.5 “Fyerja”, kur kryhet më shumë se një herë, *përbën kundërvajtje penale dhe dënohet nga pesëdhjetë mijë deri në tre milionë lekë* (neni 119 i Kodit Penal), ndërsa “përndjekja” *dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet* (neni 121/a i Kodit Penal) dhe kjo dispozitë e fundit parashikon edhe disa rrethana rënduese. Vetëkuptohet se, duke qenë se kjo është njohuri bazë ligjore që duhet të zotërojë çdo magjistrat, vepra penale e përndjekjes duhet të konsiderohet si përthithëse e veprës penale të fyerjes në rastin konkret.

89.6 Organet e *Vetting*-ut nuk duhet të mbyllin sytë para një mangësie kaq të rëndë profesionale, as nuk duhet ta fshijnë atë nga vlerësimi i tyre nëpërmjet zbatimit të nenit 59/4 të ligjit të *Vetting*-ut, pasi me elementet e tjera të çështjes kjo situatë duhet të çojë në shkarkimin e të subjektit të rivlerësimit, sepse nuk konkludohet se ai arrin një rezultat minimal pikësh në vlerësimin e aftësive profesionale.

89.7 Për më tepër, një neglizhencë e tillë serioze minon besimin e publikut në sistemin gjyqësor, pasi asnjë femër nuk do të ishte më kurrë e gatshme në të ardhmen të denonconte një situatë përndjekjeje nëse ato nuk trajtohen/gjykohen siç duhet nga autoritetet e prokurorisë e në përputhje me parimet e lidhura me CEDAW dhe Konventën e Stambollit.

89.8 Thënë këtë, vëzhguesi ndërkombëtar dëshiron të kujtojë se Kolegji i Posaçëm i Apelit e ka konsideruar tashmë negativisht vlerësimin e aftësive profesionale në të shkuarën, sa herë që ka pasur një kualifikim të gabuar të veprës penale, pasi e kanë konsideruar këtë si arsye të përshtatshme për mangësi/defekte në treguesin e arsytimit ligjor, në kuptim të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016. Rasti është i ndryshëm, por parimet mund të zbatohen në mënyrë të ngjashme. ...sjelljet e subjektit të rivlerësimit në mënyrën se si e ka trajtuar procedimin penal nr. **/2016 dhe veçanërisht nënkualifikimi i fakteve në kategorizimin e veprës si “fyerje” e jo si “përndjekje”, është gabim i rëndë sipas paragrafit 57 të vendimit të Gjykatës Kushtetuese 2/2017 dhe cenon rëndë besimin e publikut në sistemin e drejtësisë⁴¹.

⁴¹ Shihni vendimin e Kolegjit nr. 9/2020, paragrafët 16.3 – 16.10.

89.9 Vëzhguesi ndërkombëtar beson se mangësitë dhe defektet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me procedimin penal nr. ***/2016 janë të një natyre të rëndë/serioze dhe duhet të konsiderohen si “gabime të rënda” sipas kuadrit ligjor të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese.

89.10 Neglizhenca e konstatuar në trajtimin e çështjes, me nënkualifikimin e fakteve, duhet të konsiderohet se dëmton rëndë besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë. Subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të kualifikojë siç duhet dënimin e autorit të një veprë (përndjekje) të dhunës me bazë gjinore, duke e bërë kështu të paefektshëm zbatimin e parimeve të CEDAW dhe të Konventës së Stambollit në Republikën e Shqipërisë.

89.11 Si e tillë, neglizhenca dhe gabimi i lartpërmendur janë të një rëndësie të tillë, sa që nuk mund t’i referohet thjesht organit kompetent disiplinor sipas nenit 59/4 të ligjit të *Vetting*-ut, pasi duhet konsideruar se ka një ndikim vendimtar në rezultatin e këtij procesi rivlerësimi. Rezultati i këtij procesi rivlerësimi deri tani sipas vëzhguesit ndërkombëtar është ai i shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

90. Pas kalimit të barrës së provës subjekti pretendoi se⁴²: *“Në lidhje me këtë procedim penal, sqaroj se me vendimin e zëvendësimit të prokurorit, të datës 23.2.2016, më është caktuar për ndjekje për shkak se prokurorja e çështjes është transferuar në një prokurori tjetër. Me vendimin e saj të datës 26.1.2016, prokurorja e mëparshme ka vendosur të regjistrojë materialin hetimor nr. ***, datë 21.1.2016, për veprën penale “Përndjekja”, parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal, pa emër personi nën hetim.*

*Nga aktet e para hetimore ka rezultuar se në datën 18.1.2016 shtetasja P.B ka bërë një kallëzim penal, në të cilin shpjegon se është studente në Universitetin e Vlorës dhe se ka qenë e lidhur për disa muaj me shtetasin E.B. Ajo deklaron se kanë qenë në prag fejeje, por ka hequr dorë prej tij dhe janë ndarë. Ajo deklaron se E është 28 vjeç dhe se është i papunë. Ndarja mes tyre ka ndodhur në muajin dhjetor dhe, sipas kallëzimit të saj, që nga ai moment ai e ka bezdisur me telefon, duke e telefonuar dhe ofenduar me fjalë banale në numrin e saj të telefonit ***, dhe telefonatat i ka bërë me numrin e tij ***. Gjithashtu, kjo shtetase deklaron se që në momentin e ndarjes ai e telefononte dhe bisedonin normalisht, por në momentin kur ajo refuzonte të fejohej ai fillonte që ta shante.*

Në datën 18.1.2016, E i ka telefonuar në orën 02:52 të mëngjesit disa herë dhe, në momentin kur ajo i ka hapur telefonin, ky i fundit i ka thënë se e kishte marrë për t’i thënë natën e mirë. Kallëzuesja i ka thënë që të mos e merrte më dhe i ka mbyllur telefonin. Pas kësaj i ka telefonuar 28 herë të tjera, por ajo nuk i është përgjigjur. Kjo situatë i ka shkaktuar gjendje ankthi, për faktin se ajo i ka bërë të ditur se nuk e do dhe nuk do të fejohej me të. Në dijeni të kësaj situatë është shoqja e saj E.B, pasi ajo ka dëgjuar disa biseda që ka bërë me E. Lidhur me këtë fakt është pyetur shtetasi E.B në cilësinë e personit që tregon rrethana të dobishme hetimi. Në deklarin e tij, ai shpjegon se me shtetasen P.B kanë pasur një lidhje disa kohë më parë dhe se në muajin janar ata janë ndarë me njëri-tjetrin. Ai shpjegon se nuk është e vërtetë që ta ketë sharë, ofenduar apo kërcënuar P. Sipas tij, këtë gjë ajo e ka bërë për t’u hakmarrë ndaj tij, pasi ka qenë ai që i ka thënë se nuk kishin më punë bashkë. Ai e ka telefonuar pasi ka marrë dijeni për kallëzimin e saj, duke e pyetur se përse kishte bërë kallëzim ndaj tij. Ajo i është

⁴² Për më shumë referojuni shpjegimeve të subjektit pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

përgjigjur se ka qenë e mërzhitur dhe i ka kërkuar falje. Kjo telefonatë ka qenë kontakti i fundit me të, pasi nuk kanë folur më me njëri-tjetrin.

Gjithashtu i është marrë deklaram si person që tregon rrethana hetimi shoqes së saj E.B, e cila sqaron se shoqja e saj P ka qenë e lidhur me shtetasin E.B për disa muaj dhe në dhjetor janë ndarë nga njëri-tjetri. Para disa ditëve, ndërsa ka qenë me shoqen e saj, përpara i ka dalë E, i cili banon në të njëjtën lagje dhe ka ofenduar P. Këtë gjë e ka bërë edhe kur kanë qenë bashkë në lokalitë “R”, kurse P e i ka thënë se nuk kishte punë me të dhe nuk duhet ta merrte në telefon...

*Nga ana ime i është kërkuar kompanisë “V” sh.a. fluksi i thirrjeve dhe SMS-ve të numrit ***, i përdorur nga kallëzuesja, dhe numrit ***, i përdorur nga E.B, nga data 18.12.2015 deri në datën 20.1.2016. Kompania “V” ka dërguar në mënyrë elektronike informacionin e kërkuar nga ana ime. Nga këto të dhëna rezulton se nga numri *** në përdorim nga shtetasi E.B, për periudhën 18.12.2015 – 20.1.2016, janë dërguar *** telefonata dhe mesazhe në drejtim të numrit *** në përdorim nga shtetasja P.B. Ndërsa nga numri *** në përdorim nga kallëzuesja P.B, për periudhën 18.12.2015 – 20.1.2016 rezulton se janë dërguar 1244 thirrje telefonike dhe mesazhe në drejtim të numrit ***, në përdorim nga shtetasi E.B. Pas kryerjes së të gjitha veprimeve hetimore të mundshme dhe në një afat të shkurtër nga momenti që jam ngarkuar me hetimin e këtij procedimi penal, nga ana ime është konkluduar se nuk jemi para elementeve të veprës penale “Përndjekja”, parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal, duke vendosur pushimin e çështjes penale... Ky vendim rezulton se nuk është ankimuar nga ana e kallëzueses P.B në gjykatë, vërtetuar kjo me shkresën nr. ***, datë 28.3.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, sipas së cilës rezulton se shtetasja P.B nuk ka bërë ankim kundër vendimit të pushimit të procedimit penal dhe nuk ka iniciuar proces gjyqësor në cilësinë e viktimës akuzuese. Gjithashtu nuk rezulton që kjo shtetase të ketë bërë ankim tek prokurori më i lartë.*

...Nga hetimi ka rezultuar e provuar se kallëzuesja dhe i kallëzuarit prej saj, edhe pse i kanë dhënë fund lidhjes, kanë pasur komunikim të vazhdueshëm dhe të ndërsjellë me njëri-tjetrin, duke shkëmbyer në mënyrë të vazhdueshme telefonata dhe mesazhe. Megjithëse në kallëzimin e saj ajo shpjegon se i ka dhënë fund marrëdhënies me të dashurin e saj, nuk ka ndërprerë komunikimin me të, fakt i cili provohet me numrin e lartë të mesazheve dhe telefonata që ka kryer në drejtim të të kallëzuarit. Nga këqyrja e tabulateve telefonike rezulton se gjatë periudhës 18.12.2015 – 20.1.2016 shtetasja P.B e ka telefonuar dhe dërguar SMS shtetasit E. B 1244 herë. Nuk mund të bëhet fjalë në këtë rast për “ngacmime”, “imponim për ndryshimin e mënyrës së jetesës”, apo “ankth të rëndë” të shkaktuar nëpërmjet telefonit, për sa kohë kallëzuesja vazhdimisht ka kryer telefonata dhe mesazhe me personin që ajo kallëzon. Nuk ka bazë pretendimi i kallëzueses që nga telefonatat e shtetasit E.B i është shkaktuar gjendje ankthi, ndërkohë që në asnjë moment nuk ka reshtur vetë së telefonuari dhe dërguari SMS në drejtim të tij. Pikërisht në datën 18.1.2016, datë kur kjo shtetase ka depozituar kallëzimin penal, nga numri i saj i janë dërguar plot 56 SMS shtetasit E.B, dhe anasjelltas. Gjithashtu, komunikimet ndërmjet tyre kanë vazhduar edhe pas datës së kallëzimit, sikurse provohet po nga tabulatet telefonike. Të gjitha këto fakte krijojnë bindjen se në rastin konkret nuk jemi përpara elementeve të veprës penale “Përndjekja”. Bazuar në provat e mbledhura gjatë hetimit, si dhe në deklaramin e shtetases E.B, e cila ka deklaruar se ka qenë prezente në të dyja raste kur shtetasi E.B e ka ofenduar shoqen e saj P, nga ana ime është çmuar se ato përbëjnë elemente

të veprës penale “Fyerja”, parashikuar nga neni 119 i Kodit Penal, veprë e cila ndiqet me ankim të të dëmtuarit drejtpërdrejt në Gjykatë.

...Kompetenca kushtetuese dhe ligjore e organeve të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 43 e 44 të ligjit nr. 84/2016, nuk përfshin një gjykim apo vlerësim mbi logjikën apo bazueshmërinë e vendimmarrjes së një magjistrati, e cila është detyrë dhe kompetencë e organeve më të larta gjyqësore. Në këtë drejtim, gjen zbatim neni 73 i ligjit nr. 96/2016, i cili bën fjalë për vlerësimin e aftësive profesionale të prokurorit, në pikën 4 të të cilit parashikohet se: “Vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektesinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet”.

91. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit vlerëson se ato janë të plota dhe bindëse. Gjatë hetimit janë administruar tabulatet e numrit të telefonit *** të shtetasit E.B dhe nga këqyrja e tyre ka rezultuar se gjatë gjithë periudhës 18.12.2015 – 20.1.2016 të dy shtetasit kanë telefonuar dhe kanë shkëmbyer mesazhe me njëri-tjetrin. Subjekti ka trajtuar elementet e veprës penale “Përndjekja”, parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal, duke argumentuar që ekzistenca e figurës së kësaj vepre kërkonte që subjekti i veprës penale: “...duhet të kërcënonte ose të ngacmonte personin me anë të veprimeve të përsëritura dhe të vazhdueshme për t’i shkaktuar atij gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake... apo për ta detyruar atë të ndryshonte mënyrën e jetesës...”. Në analizë të provave të administruara në fashikullin e hetimit, subjekti ka konkluduar se shtetasi i kallëzuar E.B kishte konsumuar elementet e veprës penale “Fyerja”, parashikuar nga neni 119 i Kodit Penal, dhe jo të veprës penale “Përndjekja”, parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal. Duke iu referuar nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale “...ai që është dëmtuar nga veprat penale të parashikuara nga nenet 90, 91, 92, 112, paragrafi i parë, 119, 119/b, 120, 121, 122, 125, 127, 148, 149 dhe 254 të Kodit Penal, ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit...”, ka vendosur pushimin e hetimeve të procedimit penal, bazuar në nenin 328, pika 1, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Penale.

91.1 Për sa më sipër, rezulton se nga ana e subjektit janë kryer të gjitha veprimet e hetimore të nevojshme dhe nga analizimi i provave të administruar ai ka konkluduar me të drejtë që nuk jemi përpara veprës penale të përndjekjes, për sa kohë ka komunikim të vazhdueshëm midis të kallëzuarit dhe kallëzueses. Ky vendimi i subjekti rezulton të mos jetë ankimuar, për rrjedhojë, edhe kallëzuesja ka qenë dakord me vendimmarrjen e subjektit.

92. Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen mangësi të subjektit në aspektin e aftësive profesionale të parashikuara nga neni 73 i ligjit nr. 96/2016.

TË DHËNAT ARKIVORE (ankesat dhe masat disiplinore - vlerësimet)

93. Nga verifikimi në arkivin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë rezulton që ndaj subjektit të rivlerësimit nuk janë marrë masa disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës.

93.1 Mbi bazën e kërkesës për informacion, dërguar nga Komisioni, i është kërkuar informacion strukturave përkatëse të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të gjitha prokurorive

pranë shkallës së parë, si dhe janë administruar përgjigjet e shkresave, ku ka rezultuar se nuk janë regjistruar kallëzime apo procedime penale në ngarkim të shtetasit Erjon Shqarri.

93.2 Nga të dhënat e administruara nga Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. *** prot., datë 5.3.2021, rezulton se nuk janë regjistruar ankesa ndaj prokurorit Erjon Shqarri.

93.3 Për subjektin e rivlerësimit nuk është paraqitur asnjë denoncim në lidhje me aftësitë e tij profesionale.

Informacionet nga burimet mediatike

94. Nga të dhënat nga burime të hapura, Komisioni ka konstatuar se subjekti kishte nxjerrë nga burgu shtetasin Sh.L *alias* G.L. Në lidhje me këtë shtetas, Komisioni ka administruar nga Prokuroria e Rrethit Gjiqësor Vlorë të gjitha procedimet penale në emër të tij, nga ku ka rezultuar se subjekti nuk ka hetuar asnjë nga procedimet.

95. Nga ana e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit në datën 23.1.2024 është paraqitur Gjetja dhe Opinioni, si vijon:

- Vëzhguesi ndërkombëtar, referuar informacionit nga burime mediatike, të cilat mund të gjenden në *link*-un: https://shqiptarja.com/lajm/prokurori-erjon-shqarri-nxori-nga-burgu-sh-l-qe-u-ekzekutua-dje-me-h-xh-gjyqtarja-a-s-pranoi_kerkesen-si-i-shpetoi-drejtesishe-por-jo-armiqve, ku ngrihen dyshime se subjekti i rivlerësimit kishte liruar nga burgu një person, që më pas u vra, vendosi të kërkojë procedimin penal përkatës nr. ***, të hetuar nga Prokuroria e Rrethit Vlorë dhe të administruar nga ONM-ja nga Gjykata e Apelit Tiranë për analizë.

a) Historiku i çështjes lidhur me procedimin penal nr. */2022**

Në datën 22.3.2022, Policia e Komisarariatit të Vlorës ka marrë njoftim nga salla e kontrollit se në drejtim të vendit të quajtur “Rr”, zona “U i F”, një automjet tip “BMW” me targë AA *** TR dyshohej se lëvizte me një person të shpallur në kërkim. Forcat e policisë janë vendosur në një postbllok, të cilët kanë mundur të ndalojnë automjetin, brenda të cilit ndodheshin tri persona.

Pas kontrollit dhe verifikimit rezultoi se në sediljen e pasme të mjetit ishte ulur personi i shpallur në kërkim A.F.K, i datëlindjes 4.4.2001. Policia ka kryer kontroll fizik dhe ka konstatuar se mbante një pistoletë me ngjyrë të zezë. Dy personat e tjerë janë identifikuar drejtuesi i mjetit, shtetasi K.Z.D, i datëlindjes 20.8.1972 dhe shtetasi S (Sh) T.L (*alias* G.L), i datëlindjes 18.9.1985. Oficerët e policisë kontrolluan makinën me të cilën udhëtonin këta persona dhe në krah të sediljes së shoferit, pranë frenave të dorës, gjetën një çantë krahu me kuadrate të zezë dhe gri, brenda së cilës kishte një pistoletë tip “Zastava 99”.

Më pas, policia gjyqësore – gjithnjë në datën 22.3.2022 – arrestoi në flagrancë të dyshuarit A. K, K.D dhe Sh.L, si të dyshuar për veprat penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, dhe “Përkrahja e autorit të krimit”, parashikuar nga neni 302 i Kodit Penal.

Bazuar në kërkesën e Prokurorisë, të hartuar dhe nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit Erjon Shqarri (por përfaqësuar në gjykatë nga një tjetër prokuror, H.L), Gjykata e Rrethit Gjiqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 25.3.2022, ka vendosur vlefshmërinë e arrestimit në flagrancë të shtetasve A.K, K.D dhe Sh.L dhe ka vendosur përkatësisht masën e sigurimit “Arrest në

burg”, parashikuar nga neni 283 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë ndaj të dyshuarve A.K dhe K.D.

Të dyshuarit Sh.L i është caktuar masa e sigurisë “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, në zbatim dhe pranim të kërkesës së prokurorit. Sipas kërkesës, shtetasi Sh.L dyshohej vetëm për kryerjen e veprës penale “Përkrahja e autorit të krimit”, parashikuar nga neni 302 i Kodit Penal.

Ndërkohë, më 18.8.2022, i pandehuri Sh.L u vra në Vlorë dhe procedimi penal ndaj tij u pushua.

b) Analiza e procedimit penal nr. */2022**

Vëzhguesi ndërkombëtar thekson se kërkesa e Prokurorisë, e hartuar dhe nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit Erjon Shqarri, kërkonte caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” ndaj të dyshuarve A.K dhe K.D, ndërsa ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” ndaj të dyshuarit Sh.L (*alias* G.L).

Nga shqyrtimi i këtij dokumenti ligjor, ky vëzhgues ndërkombëtar dëshiron të theksojë mungesën e një arsytimi të përshtatshëm, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka shtjelluar kushtet konkrete, për të cilat ka kërkuar masat e sigurisë në fjalë, në veçanti për të dyshuarin Sh.L. Përveç referimit në tekst të dispozitave ligjore të Kodit të Procedurës Penale (përcaktimi i kërkesave/kritereve për zbatimin e masave të sigurimit personal – nenet 228 dhe 229 të Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë), subjekti i rivlerësimit nuk ka vlerësuar dhe analizuar, në bazë të provave të disponueshme, rrethanat konkrete të çështjes lidhur me rrezikshmërinë shoqërore të shtetasit Sh.L, rëndësinë e fakteve penale që i atribuoheshin, dënimet ose procedimet e mëparshme ndaj tij, si dhe çdo rrethanë rënduese ose lehtësuese.

Po ashtu, në kërkesë thuhet se i dyshuari Sh.L nuk ka qenë i dënuar më parë, në kundërshtim me aktet e administruara në dosje, që tregojnë të kundërtën⁴³.

Gjithashtu, nga burime të hapura⁴⁴ u konstatua se në vitin 2019 shtetasi Sh.L (*alias* G.L) është hetuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (e njëjta prokurori) për veprat penale të parashikuara nga nenet 79/dh dhe 278/1 të Kodit Penal dhe në përfundim të hetimeve i pandehuri është akuzuar për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”, sipas nenit 300 të Kodit Penal. Sa më sipër, rezulton se ndaj shtetasit Sh.L (*alias* G.L) ka qenë në proces një tjetër çështje penale në momentin që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesën për caktimin e masës së sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” në kuadër të procedimit penal nr. ***/2022.

Gjithmonë nga burime të hapura⁴⁵ rezulton se shtetasi Sh.L (*alias* G.L) ka qenë nën hetim nga autoritetet italiane për krime të lidhura me drogën dhe në datën 21.11.2017 i është nënshtruar një urdhërarresti për ekzekutimin e urdhrit të burgimit, lëshuar nga Gjykata e Romës, dhe është dënuar me 10 muaj burgim. Është vërtetuar se shtetasi G.L (Sh.L) ka kryer veprën penale për

⁴³ Pavarësisht se në dosje është administruar vërtetimi përkatës, që tregon se ka precedentë të mëparshëm penalë të regjistruar në emër të të pandehurit Sh.L (*alias* G.L).

⁴⁴ Siç përcaktohet nga arsytimi i vendimit nr. ***, datë 29.6.2021, lëshuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë (gjeneruar nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë të Shqipërisë).

⁴⁵ Ibid.

pjesëmarrje në organizatën që siguronte, transportonte dhe shpërndante lëndë narkotike të llojit marijuanë (e shënuar në këtë vendim si procedimi penal nr. *** RGNR - formulari 21)⁴⁶.

Siç u analizua më lart, të gjitha këto fakte që kanë të bëjnë me të dyshuarin nuk janë shqyrtuar dhe analizuar aspak nga subjekti i rivlerësimit në kërkesën e tij drejtuar gjykatës.

Vëzhguesi ndërkombëtar beson se mangësitë e subjektit të rivlerësimit në lidhje me procedimin penal nr***/2022 duhet të përdoren ose për të vlerësuar aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit në kuptim të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, ose si mjet ndihmës për vlerësimin e përgjithshëm të procesit të rivlerësimit të tij, sipas leximit të kombinuar të neneve 61/5 dhe 4/2 të ligjit nr. 84/2016.

Vëzhguesi ndërkombëtar dëshiron të ritheksojë pikëpamjen e tij se mangësitë si prokuror, të konstatuara nga analiza e dosjeve të subjektit të rivlerësimit (duke pasur parasysh dokumentet e tjera të këtij vëzhguesi ndërkombëtar) janë të një natyre serioze, që duhen konsideruar si “gabime të rënda” në bazë të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, që do të çonin në shkarkimin e subjektit të rivlerësimit.

96. Pas kalimit të barrës së provës subjekti pretendoi se⁴⁷: *“Në Gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar citohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka vlerësuar dhe analizuar – në bazë të provave të disponueshme – rrethanat konkrete të çështjes lidhur me rrezikshmërinë shoqërore të shtetasit Sh.L, rëndësinë e fakteve penale që i atribuoheshin, dënimet ose procedimet e mëparshme ndaj tij, çdo rrethanë rënduese ose lehtësuese.*

Po ashtu, në kërkesë thuhet se i dyshuari Sh.L nuk ka qenë i dënuar më parë, në kundërshtim me aktet e administruara në dosje, që tregojnë të kundërtën.

Lidhur me këtë qëndrim, sqaroj se materialet hetimore janë referuar nga policia gjyqësore dhe ndër aktet e tjera janë procesverbali i arrestimit në flagrancë, procesverbali i kontrollit personal dhe pyetja në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet e shtetasit Sh.L. Në të tria këto akte, por edhe në informacionin për referimin e veprës penale, policia gjyqësore është referuar vetëm me emrin Sh.L dhe në të tria procesverbalet është referuar se ky shtetas është i padënuar më parë. Gjithashtu, bashkëngjitur materialit referues është dërguar një printim nga sistemi TIMS, ku nuk rezulton që ky shtetas të jetë i dënuar apo të këtë ndonjë masë sigurimi në ngarkim të tij.

Duke qenë se kërkesat për vleftësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit janë kërkesa të ngutshme për shkak të afateve që ka vendosur Kodi i Procedurës Penale, në të gjitha rastet kërkesa mbështetet vetëm në aktet e referuara nga policia gjyqësore. Duke i konsideruar të mjaftueshme aktet e para hetimore, të cilat na janë vënë në dispozicion nga policia gjyqësore, përfshirë edhe printimin nga sistemi TIMS, ku rezulton se ky shtetas nuk kishte precedentë penalë, si dhe nuk rezultonte që të kishte emër tjetër, emër me të cilin është dënuar, është vendosur nga ana ime të kërkohet caktimi i masës së sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

Në lidhje me “gjetjen”, dëshiroj të sqaroj se, në rastin konkret, kërkesa për caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, të parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, është rezultat i zbatimit

⁴⁶ Përmendur/përcaktuar në arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Lartë të Shqipërisë nr. ***/2021.

⁴⁷ Për më shumë referojuni shpjegimeve të subjektit pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

të: (i) kushteve të përgjithshme; (ii) kushteve të posaçme për caktimin e çdo mase sigurimi, praktikës gjyqësore, jurisprudencën e GJEDNJ-së, Gjykatës së Lartë, si dhe të gjitha provave të administruara gjatë 48 orëve nga policia gjyqësore.

Nga ana ime janë zbatuar kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit, si dhe është zbatuar parimi i përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit. Në bazë të këtyre parimeve në momentin e individualizimit, se cila nga masat do të zbatohet, nga ana ime është mbajtur parasysh se ndër masat e sigurimit duhet të zgjidhet ajo më pak e rënda për të arrestuarin. Gjithashtu është mbajtur parasysh që masa e sigurimit të jetë në proporcion me rëndësinë e faktit dhe sanksionin që parashikon vepra penale që i atribuohet të dyshuarit.

Bazuar në natyrën dhe rrezikshmërinë e veprës penale dhe në zbatim të nenit 230/1 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se “Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të të pandehurit”, kam vlerësuar se masa më e përshtatshme e sigurimit për këtë person nën hetim ishte masa e sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, të parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale.

Kjo vepër penale konkrete parashikon si sanksion gjobë ose burgim gjer në pesë vjet. Ndërkohë, nga ana ime është kërkuar caktimi i masës së sigurimit “Arrest në burg” për dy personat e tjerë, të cilët janë akuzuar për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”. Gjithashtu, dëshiroj të theksoj se në caktimin e masës së sigurimit për shtetasin Sh.L janë mbajtur parasysh edhe kushtet për caktimin e masave të sigurimit, të parashikuara nga neni 228 i Kodit të Procedurës Penale. Konkretisht, kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen e provës, kur personi nën hetim rrezikon të largohet, ose kur ka rrezik se mund të kryejë vepër tjetër penale. Në rastin konkret, bazuar në kushtet e mësipërme dhe në aktet e para hetimore të dërguara nga policia gjyqësore, masa e sigurimit për shtetasin Sh.L ka qenë efektive pasi, sikurse është e provuar nga hetimi, në asnjë rast nuk është vënë në dyshim marrja e provave, të ketë pasur rrezik i keje, apo të ketë kryer vepër tjetër penale deri në momentin që dosja është dërguar për gjykim.

Dua të sqaroj një rrethanë të rëndësishme që ka të bëjë me faktin se në momentin e paraqitjes së kërkesës për vleftësim dhe caktim mase sigurimi nuk kam pasur asnjë dënim që personi ishte i dënuar. Një fakt i tillë ka rezultuar nga hetimi i mëvonshëm, kur është administruar certifikata elektronike e gjendjes gjyqësore, e cila mban datën 21.7.2022, por dua të theksoj se në këtë certifikatë rezulton i dënuar vetëm me emrin G.L, fakt për të cilin unë nuk kam qenë në dënim, pra që ky shtetas është dënuar me emër tjetër. Kjo certifikatë rezulton të jetë pjesë e fashikullit të gjyqësorit, por nuk është pjesë e fashikullit të caktimit të masës së sigurimit, e provuar kjo nga kopja e fashikullit të masës së sigurimit, e marrë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, të cilën po jua vë në dispozicion. Pra, ashtu sikurse citova më lart, në caktimin e masës së sigurimit jam bazuar në aktet e referuara nga policia gjyqësore, ku më është referuar vetëm me emrin Sh.L dhe që ky person është i padënuar më parë. Gjithashtu, nga kërkimi në sistemin TIMS nuk rezulton që të jetë shënuar dënim apo masë sigurimi në emrin Sh.L. Në fashikullin e gjyqësorit është përfshirë edhe certifikata, që tregon se ky shtetas është i dënuar më parë, por kjo rrethanë ka rezultuar më pas nga hetimi, fakti i të qenit i dënuar më parë, por me emrin G.L, fakt i cili do të mbahej parasysh nga ana ime në caktimin e llojit dhe masës së dënimit.

Pra, në këtë vlerësim, në zbatim edhe⁴⁸ të vendimit unifikues nr. 7/2011 të Kolegjeve Bashkuara të Gjykatës së Lartë, është mbajtur në konsideratë: i. Personi nën hetim dyshohej për kryerjen e veprës penale të parashikuar në nenin 302/1 të Kodit Penal, e cila paraqet rrezikshmëri mesatare shoqërore, nisur nga natyra e sanksionit që ajo parashikon gjobë ose burgim deri në pesë vjet; ii. Mënyra e kryerjes së veprës penale nga i dyshuari, shoqërimi i personit nën kërkim. Nga provat e administruara deri në atë fazë rezultonte se personi nën hetim ishte në sediljen e parë të pasagjerit, nën shoqërinë e dy shtetasve të tjerë, njëri nga të cilët në kërkim, dhe të pajisur me armë; iii. Pasojat e kryerjes së veprës penale. Në rastin konkret, vepra penale që ky person kishte kryer nuk kishte sjellë ndonjë pasojë konkrete, si në dëm të shtetit dhe drejtësisë apo të qytetarëve; iv. Në rastin konkret është kryer individualizimi i caktimit të masës së sigurimit për secilin person të arrestuar në atë ngjarje. Kjo duke diferencuar natyrën e veprës dhe autorit për secilin rast. Nisur nga veprimet, rrezikshmëria dhe natyra e veprës së dyshuar për personin nën hetim Sh. L në raport me dy personat e tjerë. Pra, rezulton qartë se në rastin konkret personaliteti dhe rrezikshmëria e personit nën hetim është vlerësuar drejt, në raport me natyrën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së saj dhe provave të administruara deri në atë fazë të hetimit.

Lidhur me këtë procedim penal, është e rëndësishme të theksoj faktin se shtetasi Sh.L gjatë hetimit të çështjes penale ka zbatuar me përpikëri këtë masë sigurimi, nuk ka kryer vepra të tjera penale, nuk ka dëmtuar marrjen e asnjë prove dhe nuk ka pasur rrezik ikjeje.

*Në vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë nr. ***, datë 25.3.2022, në faqen 7, paragrafët 3 dhe 5 argumentohet se: “Kërkesa e prokurorisë është e drejtë dhe, si e tillë, duhet pranuar. Si përfundim, çmohet se masa më e përshtatshme e A.K dhe K.D për rastin konkret është ajo e “Arrestit në burg”, ndërsa për të dyshuarin Sh.L gjykata çmon se masa më e përshtatshme është “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale”. Pra, edhe Gjykata ka vlerësuar se masa e kërkuar për të pandehurin Sh. L është e përshtatshme.*

Pra, edhe Gjykata e ka gjetur të drejtë kërkesën për vleftësimin e arrestit dhe për llojin e masave të sigurimit personal të kërkuar nga ana ime.

Vlerësoj se argumentet e mia për aplikimin e masës së sigurimit “Detyrim për paraqitje” janë jo vetëm në pajtim me ndryshimet e ndodhura në ligjin procedural me ligjin nr. 35/2017, por gjenden në harmoni edhe me standardet e konsoliduara të GJEDNJ-së, të cilat konfirmohen më tej në udhëzimin e Këshillit të Europës në botimin e datës 31.8.2022 (shihni <https://ks.echr.coe.int>), për mënyrën e aplikimit të nenit 5 të KEDNJ-së.

GJEDNJ-ja në udhëzuesin e saj thekson se vazhdimi i arrestit nuk mund të përdoret për të parashikuar një dënim me burgim. GJEDNJ-ja ka arsyetuar në vendimet e saj se, edhe pse një person akuzohet për një krim, si rregull, ai duhet të jetë i lirë, në pritje të gjykimit, ndërsa kufizimet e lirisë së tij me masa sigurimi, përbëjnë përjashtim...

⁴⁸ “Kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale, edhe pse i japin gjykatës diskrecion të gjerë për të vendosur, qartazi synojnë proporcionalitetin, përshtatshmërinë specifike të llojit të masës së sigurimit të caktuar me vetë nevojat e sigurimit për atë rast konkret. Nëse nuk ka shkaqe që e përjashtojnë autorin nga përgjegjësia penale, këto kritere imponojnë detyrimin e gjykatës për të bazuar vendimin, nga njëra anë, në dyshime të arsyeshme bazuar në prova mbi kryerjen e veprës penale prej tij dhe, nga ana tjetër, në prova që përmbajnë aq elemente të mjaftueshme, objektive e subjektive, mbi rrethanat e çështjes, të cilat tregojnë se ekziston gjendja e rrezikut dhe shkallën e rrezikut, së paku sipas njërit prej rasteve të nenit 228”.

Kompetenca kushtetuese dhe ligjore e organeve të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 43 e 44 të ligjit nr. 84/2016, nuk përfshin një gjykim apo vlerësim mbi logjikën apo bazueshmërinë e vendimmarrjes së një magjistrati, e cila është detyrë dhe kompetencë e organeve më të larta gjyqësore. Në këtë drejtim gjen zbatim neni 73 i ligjit nr. 96/2016, i cili bën fjalë për vlerësimin e aftësive profesionale të prokurorit, në pikën 4 të të cilit parashikohet se: “Vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet”.

Në nenin 3 të ligjit nr. 96/2016, paragrafi i dytë, parashikohet: “Magjistrati ushtron funksionet në mënyrë të pavarur, duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brendshme, i lirë nga çdo ndikim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye”.

Ndërkohë, neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, nuk flet aspak për bazueshmërinë e arsytimit të subjekteve gjatë rivlerësimit. Në këtë dispozitë parashikohet se: “Vlerësimi i aftësive për prokurorët përfshin aftësinë për të hetuar dhe për të ngritur akuzë publike, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, si dhe cilësitë personale bazuar në standardet e parashikuara me ligj”. Gjithashtu, nenet 40, 41, 42, 43 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016 nuk parashikojnë në asnjë rast se organet e rivlerësimit mund të gjykojnë në lidhje me bazueshmërinë ose jo të zgjidhjes së çështjes dhe bazueshmërinë e arsytimit të vendimit.

...Vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të magjistratit pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e magjistratit që vlerësohet.

Në lidhje me këtë aspekt, në qëndrimin e mbajtur nga KPA-ja në vendimin nr. 21 (JR), datë 13.9.2019, në paragrafin 19.3, faqja 15 konkludohet se: “Sipas përcaktimit të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, kriteri i aftësive profesionale të gjyqtarit vlerësohet bazuar në aspektet e njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor, por pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet”.

97. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato janë bindëse. Subjekti ka argumentuar dhe ka provuar mungesën e dijenisë së tij për dënime të mëparshme të shtetasit Sh.L *alias* G.L. Nga aktet e procedimit penal provohet se certifikata e gjendjes gjyqësore është administruar pas kërkesës për caktimin e masës së sigurimit. Subjekti ka provuar se bazuar në aktet e administruara deri në momentin e kërkesës për masën e sigurimit, të cilat janë vënë në dispozicion nga policia gjyqësore, përfshirë edhe printimin nga sistemi TIMS, rezulton se ky shtetas nuk kishte precedentë penalë, si dhe nuk rezultonte që të kishte emër tjetër.

98. Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen mangësi të subjektit në aspektin e aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 73 i ligjit nr. 96/2016.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

99. Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLP-ja, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

100. Në përfundim të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues për këtë kriter. Pavarësisht nga ky konstatim, si dhe nga sa u përshkrua më sipër, Komisioni, duke u bazuar në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelit⁴⁹, vlerëson se edhe sikur në rast se në të dyja çështjet e mësipërme mund të ishin konstatuar mangësi profesionale nga ana e subjektit, ato nuk ngrihen në nivelin e shkakut, që e bëjnë subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm, në kuptim të nenit 44, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, për të justifikuar vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 4 e këtij ligji apo për t’u konsideruar se nga ana e subjektit është cenuar besimi i publikut tek sistemi i drejtësisë sipas parashikimeve të nenit 61/5, apo të konsiderohen si mangësi të mjaftueshme në formimin profesional të subjektit, që mund të riparohen nëpërmjet Shkollës së Magjistraturës.

101. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se subjekti:

- a. arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Për këto arsye,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Erjon Shqarri, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

⁴⁹ Vendimet nr. 31/2023, nr. 33/2021, nr. 28/2020 dhe nr. 21/2019.

4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 09.04.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU

Kryesuese

Genta Tafa (BUNGO)

Relatore

Roland ILIA

Anëtar

Sekretare gjyqësore

Etmonda Hoxha